

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN(BASHKINË) PUSTEC

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **komunën(Bashkinë) Pustec**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2013 deri më 31.12.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 75, datë 16.06.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 256/5, datë 16.06.2015, i ka rekomanduar z.Edmond Themelko, Kryetar i komunës(Bashkisë) Pustec, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në Komunën Pustec, nuk u gjet regjistri i raportimeve dhe masave të marra për parandalimin e mashtrimit dhe parregullsive, ndërkohë për minimizimin e riskut, mashtrimit dhe parregullsive, nga nëpunësi autorizues nuk janë regjistruar dhe raportuar masat e marra për parandalimin e tyre sipas nenit 21, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”. Gjithashtu nuk është miratuar dhe vënë në funksionim sistemi informacioni dhe komunikimi.

1.1 Rekomandim:

a. Grupi i menaxhimit strategjik të kësaj njësisë publike, të marrë masa për hapjen dhe mbajtjen e regjistrit të raportimeve dhe masave të marra për parandalimin e mashtrimit dhe parregullsive.

b. Nëpunësi autorizues të marrë masa dhe të organizojë punën në administratën e njësisë, me qëllim minimizimin e riskut, mashtrimit dhe parregullsive, si dhe të regjistrohen e raportohen masat e marra për parandalimin e tyre, gjithashtu të miratohet dhe vihet në funksionim sistemi i informacionit dhe komunikimit.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Komuna Pustec, nuk ka zbatuar sistemin e konkurrimit të hapur, për marrjen në punë, duke u bazuar në meritat e secilit dhe mbas marrjes në punë për rekrutimet e reja, nuk janë bërë programe të trajnimit të tyre gjatë periudhës së provës. Ka rekrutime të reja dhe të vjetra, që nuk përputhen me vendin e punës sipas specialitetit të tyre ose janë me arsim të mesëm si: përgjegjësi i urbanistikës, specialist i prokurimeve dhe projekteve, inspektor i Zyrës së shërbimit etj.

2.2. Rekomandim: Komuna Pustec në kuadër të riorganizimit si Bashki, të marrë masa dhe të zbatojë sistemin e konkurrimit të hapur për marrjen në punë dhe për rekrutimet e reja, të bëhen programe trajnimi, gjatë periudhës së provës, duke siguruar përputhshmërinë e vendit të punës me arsimin dhe specialitetin përkatës.

Vazhdimisht

3. Gjetje nga auditimi: Komuna Pustec rezulton se nuk ka mbajtur regjistrin e aktiveve të qëndrueshme, ku të pasqyrohen të dhënat e nevojshme si: data e hyrjes, apo marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhja, vlera e akumuluar e amortizimit sipas kërkesave të kapitullit III, pika 30 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe të kryhet inventarizimi i tyre.

3.1. Rekomandimi :Zyra e financës së komunës të marrë masa, që të krijohet regjistri i aktiveve të qëndrueshme ku të pasqyrohen të dhënat e mësipërme dhe të kryhet inventarizimi i tyre.

Brenda datës 30.09.2015

4. Gjetje nga auditimi: Komisioni i inventarizimit, për periudhën e audituar megjithëse ka kryer inventarët përkatës, nuk është zbuluar asnjë diferencë, nuk është përpiluar raporti përmbledhës, ku të jetë përcaktuar shkalla e amortizimit të akumuluar dhe gjendja aktuale e aktiveve afatgjatë.

4.1. Rekomandimi: Komuna Pustec të marrë masa për kryerjen e inventarizimit të plotë të aktiveve afatgjata, duke krahasuar rezultatin me gjendjen kontable dhe pasi të krijohet regjistri i aktiveve të qëndrueshme, nga zyra e financës të merren masa për rillogariten e amortizimit për vitin 2013 dhe 2014, në zbatim të pikës 96 “Procesi i vlerësimit të aktiveve”.

Brenda datës 30.09.2015

5. Gjetje nga auditimi: Komuna Pustec ka përfituar nga fondet e IPA-s (program i përbashkët ndërkufitar Greqi- Shqipëri, Maqedoni), një Varkë me energji diellore në vlerën 110,000 Euro, financuar për projektin “Green Boat” nga Bashkimi Europian.

Pranë komunës është bërë hyrje vetëm t.v.sh.-ja, sipas fletë hyrjes nr. 20, datë 10.12.2014, në vlerën 3,148,200 lekë dhe jo mjeti tip varke e ardhur nga Greqia sipas kontratës nr. 687, datë 29 tetot 2013 në vlerën 110,000 Euro. Mos bërja hyrje e varkës në vlerën e plotë dhe reale, veprim në kundërshtim me paragrafin III pika 35 germa a, b, c. pika 37, 38 e 39. Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara nëni 42, 43 dhe 44 germa a, pika 47, 48 e 50. Transporti i aktiveve pika 51 dhe Kapitulli i IV “Inventarizimi i aktiveve pika 37, të udhëzimit MF nr. 30, datë 27.12.2011” Për menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit publik” në zbatim të ligjit 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

5.1. Rekomandimi: Zyra e financës së komunës të kryej veprimet duke bërë hyrje- dalje në magazinë, mjetin varkë, bazuar në dokumentacionin e ardhur, si dhe ti dorzohet specialistit që mbulon aktivitetet turistike konform kërkesave ligjore dhe me specifikimet e treguesit teknik që ka ky mjet.

Menjëherë

6.-Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kryer për vitin 2013 dhe 2014, rezultojnë projekte të paguar nga Komuna dhe të pasqyruar si aktive të patrupëzuara në llogarinë nr .202 “ Studime e kërkime”, ndërkohë që sipas standardit nr. 5 të kontabilitetit pikës 12, vlera e projektit në përfundim të objektit, materializohet në vlerën e aktivitetit të trupëzuar në rastin konkret, në objektet për të cilët janë blerë apo hartuar dhe regjistrohen në evidencën kontabël në llogarinë përkatëse .

6.1. Rekomandimi:

a. Zyra e financës të analizojë gjendjen e llogarisë 202 “studime e kërkime” për tepricën e saj gjendje më 31.12. 2014, me synimin regjistrimin në pozicionin e duhur sipas standardit të kontabilitetit nr. 5 pikës 12.

b. Të sistemohet shuma 677,000 lekë, që iu përket projekteve të vitit 2013 dhe 2014, në llogarinë sintetike përkatëse, sipas objekteve për të cilët janë hartuar apo blerë dhe të paraqiten në bilanc për vitin 2015.

Brenda muajit Tetor 2015

7. Gjetje nga auditimi: Komuna Pustec, nuk ka zbatuar procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve të debitorëve sipas bilancit kontabël të mbartur nga vitet e mëparshëm gjendje më 31.12.2014, në vlerën 72,768 lek, megjithëse i ka evidentuar për çdo person të 32 debitorë.

7.1. Rekomandimi: Komuna Pustec (zyra e financës) të marrë masa për te analizuar dhe saktësuar dokumentacionin ligjore për çdo debitorë dhe të ndjek gjithë procedurat ligjore për mundësimin e arkëtimit të detyrimit.

Brenda muajit Tetor 2015

8. Gjetjet e auditimit: Në hartimin e projektbuxhetit 2013, 2014, dhe të kërkesave për parashikimin e të ardhurave për periudhën 2014-2016 dhe 2015-2017, si dhe parashikimi i shpërndarjes së burimeve financiare për periudhën 2015-2017, nuk u paraqitë asnjë e dhënë. Mungon plotësimi i formularit nr. 1 “Parashikimi i të ardhurave për vitin 2014-2016 dhe 2015-2017 si dhe formulari nr. 2 “Parashikimi i shpërndarjes së burimeve financiare për periudhën 2014-2016 dhe 2015-2017: Të dy formularët që duhej dërguar brenda datës 1 Qershor 2013 dhe 1 Qershor 2014, sipas shkresës së Drejtorisë Marrëdhënieve Fiskale e Ndërqeveritare nr. 2990/3 datë 25.03.2014.

8.1.Rekomandimi: Zyra e buxhetit të marrë masa të menjëhershme për sigurimin e formularit nr 1 dhe 2, konform Udhëzimit nr. 9 dhe 9/1, datë 20.02.2013. Po kështu, nga kjo zyrë të mundësohet që bashkë me hartimin e planit të buxhetit, të përpilohet relacioni shpjegues, ku të jenë analizuar hollësisht: Objektivat që do të realizohen në kuadër të

politikave të zhvillimit, rritja e të ardhurave për të krijuar mundësi më të mëdha për financimin e projekteve të ndryshme, rritja e shpenzimeve për investime, duke ulur shpenzimet operative, etj.

Vazhdimisht

9- Gjetje nga auditimi :Në Komunën Pustec, u konstatuan subjekte të biznesit të vogël me detyrime të papaguara për vitin 2013 në vlerën 70,940 lekë dhe vitin 2014, në vlerën në vlerën 338,990 lekë, të pa pasqyruar në bilancin e komunës.

9.1 Rekomandimi: Zyra e financës të marrë masa për pasqyrimin e detyrimit në kontabilitet të shumës **409,930 lekë**. Duke ndjekur të gjitha hapat ligjorë të përcaktuara në procedurën e taksave dhe të kërkuar e arkëtohen detyrimet si e ardhur e munguar (taksa të pambledhura) e taksës ndërtesës, tarifës së pastrimit, dhe tarifës së ndriçimit, taksë së tabelës për subjektet, për vitin 2013- 2014.

Brenda datë 30.07.2015

10-Gjetje e auditimit :Nga zyra e taksave dhe tarifave vendore të Komunës Pustec, gjatë vitit 2013 dhe 2014, nuk janë ndjekur arkëtimi i detyrimeve për subjektet debitorë, për vlerën 409,930 lekë, dhe për rrjedhojë nuk ka penalizuar subjekte për mos likuidimin në afat të detyrimeve tatimore dhe të taksave e tarifave vendore në masën 5% për çdo muaj por jo më shumë se 25% për vitin 2013 dhe në masën 10% për vitin 2014, Aneksi 5 dhe 6 .

10.1. Rekomandimi: Komuna Pustec të kryej kontabilizimin e shumës 91.840, nga të cilët 87,746 lekë për vitin 2013 dhe 7.094 lekë për vitin 2014 dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e penalizimit të mësipërm, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative në zbatim të neni 93 pika 1 dhe neni 89, pika 3 dhe 4 *“Në përputhje me dispozitat e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale*.

Brenda datës 30.06.2015

11. Gjetje nga auditimi: Gjatë ushtrimit të auditimit të dosjeve të subjekteve që zhvillojnë biznesin e tyre në veprimtari tregtare apo në shërbime të ndryshme, rezultojë se për vitin 2013 dhe 2014, për pesë subjekte është faturuar më pak sipërfaqja që është shfrytëzuar për llogari të aktivitetit të ushtruar prej tyre përkatësisht 21 m² për vitin 2013 dhe 247.8 m² për vitin 2014, me efekt financiar në vlerën **53,383 lekë**, në kundërshtim me ligjin 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe vendimit të Këshillit të Komunë nr. 4 datë 31.01.2014, sipas aneksi nr. 7 .

11.1. Rekomandimi: Zyra e taksave dhe tarifave vendore, të merren masa për zbatimin e procedurave ligjore, vjeljen e detyrimeve për shumën 53,383 lekë, duke zbatuar gjithë procedurat e nevojshme administrative e ligjore.

Brenda vitit 2015

12-Gjetje nga auditimi: a, Komuna Pustec, zyra e taksave dhe tatimeve e tarifave vendore nuk ka mbledhur taksat dhe tarifave vendore të popullatës në vitin 2013 në shumën **1,865,368 lekë**, nga e cila :

- për taksën e tokës 889,218 lekë
- për taksën e ndërtesë në vlerën për 174,150 lekë
- për tarifën e pastrimit në vlerën 406,000 lekë,
- për tarifën e ndriçimit në vlerën 399,000 lekë.

b: Komuna Pustec, zyra e taksave dhe tatimeve e tarifave vendore nuk ka vjelur taksat dhe tarifave vendore të popullatës në vitin 2014 në shumën **1,860,878 lekë** nga e cila :

- për taksën e tokës bujqësore në vlerën 771,628 lekë
- për taksën e ndërtesë në vlerën për 433,300 lekë
- për tarifën e pastrimit në vlerën 345.900 lekë,
- për tarifën e ndriçimit në vlerën 310,050 lekë.

12.1-Rekomandimi: Zyra e taksave e tarifave vendore, të marrë masa për zbatimin e procedurave ligjore për vjeljen e detyrimeve për shumën **3,726,246 lekë**, si e ardhur e munguar nga taksat dhe tarifat e pa mbledhura nga popullata.

Brenda datës 31.12.2015

13. Gjetje e auditimit: Në Komunën Pustec për vitin 2014, rezulton që tatimi mbi fitimin e thjeshtë, nuk është transferuar nga Drejtoria Tatimore Rajonale, nuk është transferuar në llogarinë e buxhetit të Komunës, megjithëse është rakorduar ndërmjet palëve që nga data 22

dhjetor 2014. Vlera e pa transferuar rezulton në shumën 333,333 lekë. Veprime këto kundërshtim me ligjin 181/13, datë 28/12/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” neni 17.

13.1 Rekomandimi: Komuna Pustec dhe Zyra e taksave dhe tarifave vendore, zyra e buxhetit dhe zyra e financës, të marrin masa për kryerjen e transfertës dhe kontabilizimin të shumës së të ardhurave mbi tatimin e thjeshtuar të biznesit të vogël në vlerën 333,333 lekë, të bëhet pasqyrimi i tyre në bilanc dhe në rezultatin financiar të Komunës.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Në Komunën Pustec, emërimi në detyrën e punonjësit të Policisë së komunës, është bërë në kundërshtim me urdhrin e përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530, datë 07.04.2003 dhe Ministrit të Rendit Publik, nr. 823, datë 11.04.2003 “Për miratimin e rregullores “TIP” të policisë bashkiake dhe të Komunës”.

14.1. Rekomandimi: Komuna Pustec, të rrizhvillojë procedurat e përzgjedhjes së punonjësit të Policisë, duke zbatuar kriteret e urdhrit të përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Në Komunën Pustec nuk është ngritur Zyra për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës (ZAMT), ka vetëm një agronom i cili merret me tokat bujqësore në kundërshtim me kreun e II-të nenin 6, kreu III-të neni 10, neni 11 pikat a,b,c,d, dh, e, ë, nenin 13 pikat a, b, c të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës.

15.1. Rekomandimi: Kryetari i komunës Pustec, të nxjerr aktin administrativ për krijimin dhe funksionimin e Zyrës për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës (ZAMT).

Vazhdimisht

16. Gjetje nga auditimi: Komuna Pustec nuk i ka regjistruar në ZVRPP Korçë, pronat e transferuara, duke vepruar në kundërshtim me kreun IV, nenin 13, neni 18 ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”

16.1. Rekomandimi: Komuna Pustec të marrë masat për regjistrimin e aseteve në ZVRPP, të cilat me VKM nr. 669, datë 21.05.2008, transferohen në pronësi të Komunës Pustec, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar, neni 8 dhe VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”.

Vazhdimisht

17. Gjetje nga auditimi: Dosjet e personelit të arkivuara kanë mangësi të theksuara të dokumentacionit si mungesë të diplomave të shkollës, të dëshmisë të penalitetit, të librezave të punës, raportin mjeko ligjor, dëshmi kualifikimi, fotografi personale cw personale etj, në kundërshtim me VKM nr. 26, datë 18.3.1987, ndryshuar me VKM nr. 56, datë 30.3.1993 dhe nr. 184, datë 20.05.1981, lista e notave dhe kontrata e punës, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në Aneksin e I dhe II të VKM nr. 355, datë 07.07.2000 “Për organizimin e dosjes dhe regjistrimit personelit.

17.1 Rekomandimi: Zyra e personelit dhe kryetari i Komunës, të marrin masa për plotësimin e të gjitha mangësive të dokumentacionit të konstatuara në dosjet dhe plotësimi i tyre, të bëhet me dokumente origjinale ose me fotokopje të noterizuara.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2013, 2014 e në vazhdim IMKV në komunën Pustec ka funksionuar me 1 person, në kundërshtim me nenin 4, të ligjit 9780, datë 16.07.2007 (Trajtuar më hollësisht në fq. 77-80, të Raportit të Auditimit).

18.1 Rekomandimi: Komuna Pustec dhe Këshilli Komunës, të miratojnë dhe të vendosin pranë zyrës së IMKV në komunë 2 specialist të fushës përkatëse në zbatim të nenin 4, të ligjit 9780, datë 16.07.2007.

Menjëherë

19. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2013-2014 inspektori Ilija Themelko ka mbajtur vetëm 11 procesverbale, për pezullimin e punimeve të ndërtimeve pa leje. Nga të dhënat e Drejtorisë së Aluizni-t të Qarkut Korçë, rezulton se në këtë komunë për vitin 2013, janë deklaruar 32

ndërtime pa leje dhe në vitin 2014, janë deklaruar 27 ndërtime pa leje, në total 59 ndërtime pa leje. Nuk janë konstatuar apo mbajtur proces verbale për ndërtimet pa leje për 48 raste dhe për 11 rastet e konstatuara, nuk është mbajtur asnjë Vendim për pezullim punimesh, Vendime për Prishje Objektesh, Vendim për vendosje gjobe, dhe për 11, ndërtime objekti, nuk është vendosur gjobë në masën 200,000 lekë për objekt, në **shumën 2,200,000 lekë** dhe nuk është bërë asnjë kallëzim penal në kundërshtim me nenin 12, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit” me nenin 81 “Sanksionet” të ligjit “Për urbanistikën” dhe pikës 8 të VKM nr. 862 datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga IM Kombëtar e ai Vendor”.

19.1 Rekomandimi: Kryetari i komunës ti kërkojë inspektorit të IMKV, të ndjek të gjitha procedurat, për verifikimin e të gjitha ndërtimeve pa leje dhe për 11 ndërtim objekti të konstatuara të vendoset gjobë në masën 400,000 lekë për objekt, në shumën 2,200,000 lekë dhe në zbatim të nenin 12, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit” dhe nenin 81 “Sanksionet” të ligjit “Për urbanistikën” dhe pikës 8 të VKM nr. 862 datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga IM Kombëtar e ai Vendor”, të marri: *Vendim për prishje të objekteve pa leje të cilat të shoqërohet me vendimet e dënimit me gjobë, si dhe përgatitet kallëzim penal për kundërvajtjen.*

Menjëherë

B: MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

Mbështetur në ligjin 8485, datë 08.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” pjesa e IV, kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të financave nr. 30, datë 20.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, kapitulli IV(Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim kërkimin për shpërblim dëmi në **vlerën 1,241,072 lekë , si më poshtë:**

1.Gjetje nga auditimi, kanë përfituar punonjësit e administratës udhëtim e dieta në kundërshtim me germen b, pika 3 të VKM 997, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” **në 8 të raste në shumën 125,500 lekë**, për intererarin Liqenas – Korçë dhe anasjelltas Korçë – Liqenas, kjo pagesë është e pa justifikuar, mbasi distanca për këtë interar është 25 km, në këto kushte nuk i takon ditë shërbimi ” .

1.1. Rekomandimi, Komuna Pustec, të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dh përmbartimore për kërkimin dhe arkëtimin e **vlerës 125,500 lekë**, për 8 persona, si: J.Nasto, 57,000 lekë, Llazi Stojani 10,000 lekë, Todi Andrea, 23,000 lekë, Edmond Themelko, 7,500 lekë, A.K, 7,000 lekë, A.J 12,500 lekë, N.N, 2,500 lekë, S.S 6,000 lekë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi, -Me urdhër shpenzimin **nr. 89**, datë 02.07.2013, paguar Vasil Shumaka Korçë, me nr. Nipti K837140400J, për mirëmbajtje riparim kompjuter, në shumën 25,000 lekë.Fatura e thjesht tatimore nr. 5/1, datë 15.01.2013, paraqitet për 6 zëra në vlerën 25,000 lekë, nga mbledhja e vlerave për secilin zë rezulton 22,000 lekë.Në këto kushte, subjekti V.Sh ka përfituar padrejtësisht **3,000 lekë** .

2.1. Rekomandimi, Komuna Pustec, të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbartimore për kërkimin dhe arkëtimin e **vlerës 3,000 lekë**, nga subjekti V Sh.

Menjëherë

3-Gjetje nga auditimi, Me urdhër shpenzimin **nr. 180**, datë 05.11.2013, paguar “K... I Dishnicë Korçë, me nr. Nipti K33929014A, për “Sistemim e mirëmbajtje lulishte” 94,800 lekë, nga përllogaritjet ka përfituar për shërbim të pa kryer **12,800 lekë** për 16 ditë pune për ujitje lulishte **dhe 8,800 lekë** për 11 ditë për prashitje + pastrim. Në kundërshtim me neni 7 të ligjin nr, 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar.

3.1. Rekomandimi, Komuna Pustec, të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbarimore për kërkimin dhe arkëtimin e **vlerës 21,600 lekë**, përfituar padrejtësisht nga subjekti K. I.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi, -Me urdhër shpenzimin **nr. 209**, datë 22.10.2014, paguar firma "A.. - CO" shpk Pogradec, me nr. Nipti K64112603J, për " Sistemim rruge (betonim) në fshatin Shulin", në shumën 504,000 lekë.

Nga verifikimi në vend të matjeve të punimeve rezultojë se firma "A.....CO" shpk, ka raportuar 28.60 m3 beton më shumë nga fakti, duke përfituar padrejtësisht 28.60 x 5,500 lekë = **157,300 lekë**. Në kundërshtim me neni 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar .

4.1. Rekomandimi, Komuna Pustec, të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbarimore për kërkimin dhe arkëtimin e **vlerës 157,300 lekë**, përfituar padrejtësisht nga firma "A....-CO" shpk.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi : Për periudhën objekt auditimi kanë zhvilluar aktivitet në biznesin e vogël 8 subjekte për vitin 2013, duke iu shmangur detyrimeve fiskale për vlerën 96,150 lekë nga të cilët, 64,950 lekë për vitin 2013 dhe 31,200 lekë (tarifë pastrimi, tarifë ndriçimi dhe e taksë table) për vitin 2014, në kundërshtim me nenin 40 të ligjit 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimor në Republikën e Shqipërisë" .

5.1. Rekomandimi : Komuna Pustec, të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbarimore për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës **96,150 lekë** nga 8 subjekte private që kanë zhvilluar aktivitet në biznesin e vogël për vitin 2013, vlera 64,950 lekë dhe për vitin 2014, vlera 31,200 lekë.

Brenda datës 30.10.2015

6. Gjetje nga auditimi: Janë kryer pagesa në vlerën **56,966 lekë** të operatorit ekonomik "V...." SHPK Korçë, për diferenca të konstatuara në volumet e punimeve të kryera në lidhje me zbatimin e kontratës me objekt "Sistemim, asfaltim rruga hyrëse e fshatit Liqenas, Faza I" Pustec në kundërshtim me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar. **6.1. Rekomandimi :** Komuna Pustec të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për Operatorin Ekonomik "V....." SHPK, Korçë, arkëtimin e vlerës **56,966 lekë** (pa t.v.sh), të cilën e ka përfituar padrejtësisht për punime të pakryera në zbatimin e objektit.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Janë kryer pagesa në vlerën **210,147 lekë** të Bashkimit të Operatorëve Ekonomik "A... " SHPK Korçë & "A ..." SHPK & "S....." SHPK, përfaqësuar nga shoqëria "A.... K" SHPK, për diferenca të konstatuara në volumet e punimeve të kryera në lidhje me zbatimin e kontratës me objekt "Sistemim, asfaltim rruga e fshatit Gorricë e madhe" Pustec, në kundërshtim me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar

7.1. Rekomandimi Komuna Pustec të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për Operatorin Ekonomik "A....K" SHPK, arkëtimin e vlerës **210,147 lekë** (pa t.v.sh), të cilën e ka përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e objektit.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi Janë kryer pagesa në vlerën **120,409 lekë** të operatorit ekonomik "Operatorit Ekonomik "J... & Co" SHPK, për diferenca të konstatuara në volumet e punimeve të kryera në lidhje me zbatimin e kontratës me objekt "Ndërtim Depo uji" në kundërshtim me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar .

8.1. Rekomandimi Komuna Pustec të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për Operatorin

Ekonomik "J... & Co" SHPK, arkëtimin e vlerës **120,409 lekë** (pa t.v.sh), të cilën e ka përfituar padrejtësisht për punime të pakryera në zbatimin e objektit.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2014, shoqëria "A... Com....." Sh.A. ka likuiduar vetëm 300,000 lekë nga 450,000 që duhet të paguaj si detyrim vjetor Komunës Pustec, nga kontratat e qirasë lidhur me datë 05.05.2008 dhe datë 20.11.2009, duke mos arkëtuar për llogari të Komunës **shumën 150,000 lekë**.

9.1. Rekomandimi Komuna Pustec të kërkoj në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për shoqërinë "A...Com....." Sh.A., për arkëtimin e vlerës **150,000 lekë**, për mos zbatim të kontratave të qirasë lidhur me datë 05.05.2008 dhe datë 20.11.2009

Brenda datës 30 Shtator 2015

10. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2014, Shoqëria "Eagle-Mobile" Sh.A., nuk ka likuiduar detyrimin vjetor nga kontrata e qirasë të lidhur me datë 15.06.2011, për **shumën 300,000 lekë**.

10.1. Rekomandimi Komuna Pustec të kërkoj në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për shoqërinë "E...-M..." Sh.A., për arkëtimin e vlerës **300,000 lekë**, për mos zbatim të kontratave të qirasë lidhur me datë 15.06.2011.

Brenda datës 30 Shtator 2015

C. MASA DISIPLINORE

-Mbështetur në germa "e" dhe "ç", neni 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe kontratës individuale tip, i kemi rekomanduar Kryetarit të Komunës, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore nga "**Vërejtje**" deri "**Ndërprerje të marrëdhënie të punës**", sipas shkallës së përgjegjësisë, për këta persona:

1. I. Th me detyrë Inspektor i Ndërtimor Urbanistik Vendor.

1. nuk ka punuar me plane pune të detajuara, dhe të miratuara nga titullari i institucionit, Për periudhën objekt auditimi 2013,2014, dhe tre mujori i parë i vitit 2015.

2., nuk janë aplikuar dispozitat ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës, sipas nenit 81 "Sanksionet" të ligjit "Për urbanistikën" dhe pikës 8 të VKM nr. 862 datë 05.12.2007 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga IM Kombëtar e ai Vendor", ku përcaktohet se: *Vendimi për prishje shoqërohet me vendimet e dënimit me gjobë, si dhe përgatitet kallëzim penal për kundërvajtjen*, pasi nuk rezulton asnjë gjobë e vendosur ndaj kundërvajtësve.

3. Nga Drejtoria e Aluizmi-t të Qarkut Korçë, për vitin 2013, janë raportuar të ndërtuara 32 objekte dhe në vitin 2014, janë 27 në total ndërtime pa leje pranë kësaj komune janë 59 objekte. Ndërsa nga ana e inspektorit janë konstatuar vetëm 11 objekte pa leje, kjo tregon për një punë të dobët të këtij punonjësi.

4. Nuk ka mbajtur asnjë Vendim për pezullim punimesh, Vendime për Prishje Objektesh dhe Vendim për Dënim me Gjobë.

2. A.K, me detyrë punonjës i Policisë së Komunës

- Ka përfunduar arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe nuk është kualifikuar në Akademinë e Policisë së Rendit. Emërimi në detyrën e Punonjësit të Policisë së Komunës është bërë në kundërshtim me urdhrin e përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530, datë 07.04.2003 dhe Ministrit të Rendit Publik, nr. 823, datë 11.04.2003 "*Për miratimin e rregullores "TIP" të policisë bashkiake dhe të komunës*" dhe konkretisht me pikën 5, ku përcaktohet se: asnjë punonjës i policisë bashkiake e të komunës, nuk vendoset në detyrë pa kaluar në formim në Akademinë e Policisë së Rendit sipas programit të miratuar për këtë qëllim.

- Ka punuar pa plane pune vjetore dhe mujore të miratuara nga Kryetari i Komunës.

- Nuk ka plan operativ të përbashkët me Sektorin e Tatim Taksave për organizimin e vjeljes së të ardhurave të komunës, apo plane të tjera me struktura të tjera të komunës.
- Për vitin 2013, 2014 dhe 3 mujorin e vitit 2015, nuk ka mbajtur asnjë procesverbal, akt verifikim apo akt konstatim, si dhe nuk ka paraqitur zyrtarisht asnjë informacion ose raport mbi punën e kryer, si dhe informacion për masat e marra për urdhrat e nxjerrë nga strukturat ekzekutive dhe vendimmarrëse të komunës.
- Për periudhën 2013-2014 dhe 3 mujorin 2015, nuk është vendosur asnjë gjobë.

D. MASA ADMINISTRATIVE

D.I. Nga komunën Pustec, të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, t’i kërkojë Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, **të vendosë masë administrative me gjobë për:**

1. z. B.B, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, me licencë mbikëqyrje dhe kolaudim me nr. MK. 0503, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të punimeve në **shumën 277,709 lekë**, për tenderat .

- “Ndërtim depo uji” Komuna Pustec, me pasojë dëm ekonomik, ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **120,409 lekë pa T.V.SH**,

-“Sistemim rruge (betonim) në fshatin “Shulin Komuna Pustec, me pasojë dëm ekonomik, ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerë **157,300 lekë pa T.V.SH**, veprime në papajtueshmëri me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar.

2. z. P.P, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të punimeve me pasojë dëm ekonomik, ndajë buxhetit të njësisë vendore në tenderin “Sistemim, asfaltim rruga e fshatit Gorricë e madhe” Komuna Pustec, në **vlerën 210,147 lekë**,. veprim në papajtueshmëri me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar.

E. VLERËSIMI I CILËSISË SË AUDITIMIT

Auditimi i kryer në këtë komunë, në vlerësim të gjetjeve dhe mënyrës së pasqyrimin të tyre në materialin e evaduar, konsiderohet i dobët dhe jo i plotë, pasi nuk ka arritur të plotësojë pikat e programit të auditimit. Për këtë ky auditim do të kalojë në procesin e kontrollit të cilësisë nga Departamenti Juridik dhe Zbatimit të Standardeve, për të plotësuar praktikën e eveadimit të plotë të auditimit dhe vlerësimin e punës së grupit të auditimit në komunën Pustec, Korçë.

Nga komuna Pustec, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar plotësisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Pirro Imeraj, Mirland Çela, Bshkim Shehu dhe Skënder Muça, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT